

Unifikimi i procedurave të publikimit të vendeve të lira të punës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil takime pune me institucionet

Metodologjia që do të aplikohet, përmes portalit “E-Albania, për publikimin e pozicioneve të lira të punës, ishte në fokus të takimeve informuese që po mbahen në Tiranë nën kujdesin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Znj. Leterije Lleshi (Luzi).



Në ditën e dytë të takimeve informuese, krahas përfaqësuesve të 6 bashkive, morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e drejtësisë: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë, si dhe Avokati i Popullit dhe Instituti i Statistikave.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkoi nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të përgatisë modulet e trajnimeve të personelit që do të angazhohet me publikimin e fazave të rekrutimit, në mënyrë që të mos ketë vonesa në proces dhe të sigurohet zbatimi i hapave të përcaktuara në institutin e ligjit për shërbimin civil.



Komisioneri njoftoi se procesi do të monitorohet me rreptësi dhe se së shpejti e njëjta metodologji do të aplikohet edhe për publikimin e fazave të rekrutimit, për pozicionet e lira të punës.



Pjesëmarrësit vlerësuan nismën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për takimet informuese dhe ndërmjetësimin me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për të asistuar institucionet në përdorimin e metodologjisë për publikimin e pozicioneve të lira të punës, që do të kryhet përmes portalit qeveritar “E-Albania”.